



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 158 Datë 16.11.2012

PËR

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN E LICENSËS SË SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE SH.A, PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISE ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 08, DATE 25.01.2008, TE NDRYSHUAR DHE PËR AKTIVITETIN E FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE” TË MIRATUAR ME VENDIMET E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 09, DATË 25.01.2008 TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma a), 9 dhe 18 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; nenit 5,6,7 dhe 8 të Rregullores për Heqjen e Liçensave, miratuar me Vendimin nr. 68, datë 04.11.2005 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; Liçensës “Për aktivitetin e Furnizimit Publik me Pakicë të Energjisë Elektrike” miratuar me Vendimin nr. 09, datë 25.01.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar; Liçensës për aktivitetin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin nr. 08, datë 25.01.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar; Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjare dhe Jo-Familjare, miratuar me Vendimet nr. 108 dhe 109, datë 21.10.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike me KESH sh.a dhe CEZ Shperndarje; Marreveshjes se Transmetimit mes OST sh.a dhe CEZ Shperndarje dhe nenit 18 pika 1 gërma a) të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.11.2012, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike për heqjen e liçensës së shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a në aktivitetin e shpërndarjes dhe Furnizimit Publik me Pakicë të Energjisë Elektrike,

Vendosi :

1. Fillimin e procedures per heqje te licensave te shperndarjes se energjise elektrike dhe furnizimit publik me pakice te energjise elektrike shoqerise CEZ Shperndarje sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftoje CEZ Shperndarje per Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE.
3. CEZ Shperndarje ka te drejten per te kthyer pergjigje me shkrim brenda 30 diteve nga marrja e njoftimit, ne baze te nenit 18 te Ligjit 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”, te ndryshuar dhe nenit 8 te Rregullores se Heqjes se Licenses.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI